6415

0

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATË E RRETHIT TIRANË
Nr 6415

V E N D I M

MBI RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Në Tiranë sot më datë 22.06.94 unë gjyqtarja e Gjykatës së rrethit Tiranë , pasi mora në shqyrtim dokumentet e paraqitura nga kërkuesi Odise Nuredin Bresho , nga qyteti i Memaliajt për rregjistrimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar me emrin "Alb-buillding" si person juridik dhe :

K O N S T A T O V A

Kërkesa e paraqitur nga Odise Nuredin Bresho ,me prokurë përfaqësimi edhe të ortakut tjetër ,për rregjistrimin e shoqërisë Tregëtare prodhuese me përgjegjësi të kufizuar "Alb-buillding" për të ushtruar veprimtarinë private në fushën e ndërtimit (ndërtimin e veprave industriale social- kulturore ,rrugë ujësjellësa) shfrytëzimin , përpunimin dhe tregëtimin e materialeve inerte si dhe prodhimin e tregëtimin e materialeve të ndërtimit

Është e drejtë dhe në bazë të ligjit duhet të pranohet

PËR KËTO ARSYJE :

Në bazë të nenit 5 të ligjit Nr 751 2 datë 10-8-91 , ligjit Nr 7638 dt 19-11-92 " Për shoqëritë Tregëtare" dhe ligjit Nr 7067 dt 28-1-1993

V E N D O S A

Rregjistrimin e shoqërisë Tregëtare prodhuese "Alb-buillding" Memaliaj me përgjegjësi të kufizuar me themelues Odise Bresho e ortak Pëllumb Betaj , sipas prokurës , si person juridik për të ushtruar veprimtarinë private në fushën e ndërtimit(ndërtimin e veprave soc- kulturore ,rrugë , ujësjellësa) , shfrytëzimin e përpunimin dhe tregëtimin e materialeve inerte si dhe prodhimin e tregëtimin e materialeve të ndërtimit

Ajo do të ketë selinë në qytetin e Memaliaj,me kapital themelor fillestar prej 100000 lekë dhe administrator Odise Bresho

Kundër vendimit lejohet ankim në shkallë të dytë

G J Y Q T A R E

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 6415/1 Vendimit

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 29.7.1996 une gjyqtare e Gjykates se rrethit Tirane Mereze Sinani mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit Pellumb Betaj dhe Odise Bresho per depozitimin prane rregjistrit Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise Tregetare " Alb - Buillding, SHPK dhe

K O N S T A T O V A

Se me vendimin nr. 6415 date 22.9.1994 eshte rregjistruar si person juridik prane rregjistrit Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane shoqeria Tregetare " Alb - Buillding" SHPK.

Me vendimin e asamblese se ortakeve nr. 1 date 16.7.1996 eshte vendosur per nje shtese ne objektin e veprimtarise ne fushen e : kryerjes punimeve per hapje, shfrytezim dhe mbyllje minieras Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Me baze te ligjit 7667 date 28.1.1993 dhe te ligjit 7638 date 19.11.1992

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane rregjistrit Tregetar te vendimit te asamblese se ortakeve nr. 1 date 16.7.1996 te shoqerise Tregetare " Alb - Buillding " SHPK.

Urdherohet zyra e rregjistrit Tregetar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen 4 dhe 5 me nr, rendor 2 dhe te behet ndarja e rregjistrimeve nga njeri tjetri me vize te kuqe.

GJYQTARE
Mereze Sinani

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES PARE TIRANE
Nr. 6416/2 Regj.

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me dt. 11 maj 2005,une Gjyqtare e Gjykates se shkalles Pare Tirane ,mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Administratori i shoqerise "ALB--BUILLDING" shpk Odise BRESHO

K O N S T A T O V A - S E

Me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr.6415 dt.22.09.1994 eshte rregjistruar
si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ALB-BUILLDING" shpk. me ortak Odise BRESHO dhe Pellumb META me kuota te barabarta kapitali.

Asambleja e ortakve me vendimin e saj Nr.1 dt.11.04.2005 ka vendosur me unanimitet te plote :
1-Te miratoj bilancin e vitit ushtrimor 2004 si dhe fitimin neto te vitit per 9.277.500 leke.
2-Te behet shperndarja e fitimeve te mbartura prej 23.028.067 leke dhe e vitit 2004 prej 9.277.500 leke si me poshte : -31.900.000 leke per shtim te kapitalit te shoqerise, dhe 405.567 leke te shperndahet per ortaket si divident.
3-Te miratojne fillimin e procedurave per shtimin e kapitalit te shoqerise.
4-Te ngarkoje ekspertin kontabel te shoqerise z.Luan KAMBERI te pergatise raportin per zmadhimin e kapitalit dhe ta paraqes ne Asamblene e shoqerise per miratim.
5-Ngarkohet administratori i shoqerise Odise BRESHO te beje depozitimin e Vendimit ne Rregjistrin tregtar prane Gjykates se shkalles se Pare Tirane.

Kerkesa gjendet e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE:

Bazuar ne Ligjin Nr.7667 dt.28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar" dhe te Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per Shoqerine Tregtare";

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.
Depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se shkalles Pare Tirane te Vendimit Nr.1 te Asamblese se Otakeve te Shoqerise "ALB-BUILLING" shpk te dt.11.04.2005
Te reflektohet ky ndryshim ne fleten perkatese te Rregjistrit Tregtar te Gjykates rrethit Tirane dhe konkretisht ne kolonen _____ germa_____
Te ndahen rregjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.
Kunder ketij Vendimi lejohet ankim.

G J Y Q T A R I

Aria ne Coço

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES PARE TIRANE
Nr.6415/3 Regj.

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me dt. 13 maj 2005,une Gjyqtare e Gjykates se shkalles Pare Tirane ,mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Administratori i shoqerise "ALB--BUILLDING" shpk Odise BRESHO

K O N S T A T O V A - S E

Me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr.6415 dt.22.09.1994 eshte rregjistruar
si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ALB-BUILLDING" shpk. me ortak Odise BRESHO dhe Pellumb BETA me kuota te barabarta kapitali.

Asambleja e ortakve me vendimin e saj Nr.2 dt.25.04.2005 ka vendosur me unanimitet te plote :

1-Te miratoj rportin e ekspertit Kontabel te autorizuar Z.Luan KAMBERI per zmadhimin e kapitalit te shoqerise me 31.900.000 leke nga fitimet e vitit dhe te mbartura te shoqerise. .Zmadhimi do te behet duke rritur vleren nom inale te pjeseve te sejcilit ortak.

-Kapitali neneshkruar i shoqerise nga 100.000 leke rritet edhe me 31.900.000 leke duke u bere 32.000.000 leke.

-Vlera e re e nje kuote mbas zmadhimit te kapitalit do te jete 32.000 leke sejcila.

2-Te miratoj ndryshimet ne piken 5 te Aktit te Themelimit per pjesne e kapitalit themeltar e cila riformulohet si me poshte:

-Kapitali themeltar i shoqerise nga 100.000 leke(njqind mije) leke behet 32.000.000.leke (tridhjete e dy miljon)leke.

3-Te miratojne ndryshimet ne Statutin e Shoqerise ne Kpitullin 2 neni 7 Kpitali Themeltar i shoqerise i cili riformulohet si me poshte:

-Kapitali themeltar i Shoqerise nga 100.000(njqind mije) leke behet 32.000.000.(tridhjete e dy miljon)leke,i ndare ne 100 pjese,me nje vlere nominale 320.000(treqind e njezet mije) leke sejcila .Sejcili ortak zoteron nga 50(pesedhjete) pjese te kapitalit te shoqerise sejcili.

4-Te miratoje ndryshimet ne Statutin e Shoqerise ne Kapitullin 1 neni 5 i cili riformulohet si me poshte:

-Kohe zgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete me afate te pakufizuar.

Kerkesa gjendet e drejte dhe si e tille duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE:

Bazuar ne Ligjin Nr.7667 dt.28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar" dhe te Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per Shoqerine Tregtare";

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se shkalles Pare Tirane te Vendimit Nr.2 te Asamblese se Otakeve te Shoqerise "ALB-BUILLING" shpk te dt.25.04.2005.

Te reflektohet ky ndryshim ne fleten perkatese te Rregjistrit Tregtar te Gjykates shkalles Parerre Tirane dhe konkretisht ne kolonen _____ germa_____

Te ndahen rregjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

Kunder ketij Vendimi lejohet ankim.

GJYQTARE

Ariona Coco

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR TIRANE
NR. 6415 /4 VENDIMI

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 10.07.2006 une Blerina Muca, Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, pasi u njoha me materialet e paraqitura nga:

KERKUES: Odise Bresho, me cilesine e me cilesine e administratorit te shoq "ALB-BUILLDING" shpk,

K O N S T A T O V A:

Me vendimin nr 6415 dt 22.09.1994 te Gjykates se Rrethit, Tirane, eshte regjistruar si person juridik shoqeri "ALB-BUILLDING" shpk, me ortak Odise Bresho dhe Pellumb Betaj, me administrator Z. Odise Bresho dhe kapital themeltar 32.000.000 leke.

Me vendimin nr 2 te dt 29.06.2006 te Asamblesa e Jashtezakonshme e Ortakeve te shoq "ALB-BUILLDING" shpk, ka vendosur:

1. Te miratojne fillimin e procedurave per shtimin e kapitalit te shoqerise nga fitimet e vitit ushtrimor 2005.
2. Te ngarkoje ekspertin Kontabel te shoqersie, Z. Luan Kamberi te pregatise raportin per zmadhimin e kapitalit dhe ta paraqes ne Asamblene e Ortakeve te Shoqerise.
3. Ngarkohet administartori i shoqerise Z. Odise Bresho te beje depozitimin e vendimit ne Regsjitrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor, Tirane.
4. Vendimi te perpilohet ne 3 kopje te barazvlefshme dhe te nenshkruhet rregullisht nga ortaket e shoqerise.

Meqenese kerkesa e bere dhe dokumentat e paraqitura i plotesojne te gjitha kushtet ligjore, cmoj se ajo duhet pranuar.

PER KETO ARESYE :

Ne baze te ligjit nr.7638 dt l9.ll.1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe ne baze te ligjit nr. 7667 date 28.0l.l993 "Per Regjistrimin ne Regjistrin Tregtar"

V E N D O S A:

Depozitimin e vendimit nr 2 te dt 29.06.2006 te mbledhjes se asamblese se jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise "ALB-BUILLDING" shpk, Tirane per:

1. Miratimin e fillimit te procedurave per shtimin e kapitalit te shoqerise nga fitimet e vitit ushtrimor 2005.
2. Ngarkimin e ekspertit Kontabel te shoqerise, Z. Luan Kamberi te pregatise raportin per zmadhimin e kapitalit dhe ta paraqes ne Asamblene e Ortakeve te Shoqerise.
3. Ngarkohet administartori i shoqerise Z. Odise Bresho te beje depozitimin e vendimit ne Regsjitrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor, Tirane.
4. Vendimi te perpilohet ne 3 kopje te barazvlefshme dhe te nenshkruhet rregullisht nga ortaket e shoqerise.

-Te ndahen regjistrimet nga njeri- tjetri me vije te kuqe dhe te behen shenimet ne kollonat perkatese.

Tirane, me 10.07.2006

G J Y Q T A R E

BLERINA MUÇA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR TIRANE
NR. 6415/15 VENDIMI

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 12.07.2006 une Blerina Muca, Gjyqetare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, pasi u njoha me materialet e paraqitura nga:

KERKUES: Odise Bresho, me cilesine e me cilesine e administratorit te shoq "ALB-BUILLDING" shpk,

K O N S T A T O V A:

Me vendimin nr 6415 dt 22.09.1994 te Gjykates se Rrethit, Tirane, eshte regjistruar si person juridik shoqeri "ALB-BUILLDING" shpk, me ortak Odise Bresho dhe Pellumb Betaj, me administrator Z. Odise Bresho dhe kapital themeltar 32.000.000 leke.

Me vendimin nr 3 te dt 03.07.2006 te Asamblesa e Jashtezakonshme e Ortakeve te shoq "ALB-BUILLDING" shpk, ka vendosur:
1.Te miratojne raportin e ekspertit kontabel te Autorizuar Z. Luan Kamberi per zmadhimin e kapitalit te shoqerise me 53.400.000 leke nga fitimet e vitit ushtrimor 2005. Zmadhimi do te behet duke rritur vleren nominale te pjeseve te seicilit ortak.
-Kapitali i neshkruar i shoqerise nga 32.000.000 leke rritet dhe me 53.400.000 leke, behet 85.400.000 leke.
Vlera e re e nje kuote mbas zmadhimit te kapitalit do te jete 854.000 leke seicila.
2. Te miratoje ndryshimet ne piken 5 te Aktit te Themelimit per pjesen e kapitalit themeltar e cila riformulohet si me poshte: Kapitali themeltar i shoq nga 32.000.000 (tridhjeteedymilion)leke behet 85.400.000 leke(tetedhjetepesemiljonekaterqinmije)leke.
3.Te miratojne ndryshimet ne Statutin e shoqerise ne kapitullin 2 neni 7 Kapitali themeltar i shoq i cili riformulohet si me poshte: Kapitali themeltar i shoq nga 32.000.000 leke behet ne 85.400.000 leke, i ndare ne 100 pjese e nje vlere nominale prej 854.000 leke seicila. Seicili ortak zoteron 50 pjese te kapiatlit te shoqerise.
4. Ngarkohet administartori i shoq Odise Bresho te beje depozitimin e vendimit ne Regjistrin Tregtar.

5. vendimi perpilohet ne 3 kopje te barazvlefshme dhe te nenshkruhet rregullisht nga ortaket e shoqerise.

Meqenese kerkesa e bere dhe dokumentat e paraqitura i plotesojne te gjitha kushtet ligjore, cmoj se ajo duhet pranuar.

PER KETO ARESYE :

Ne baze te ligjit nr.7638 dt l9.ll.1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe ne baze te ligjit nr. 7667 date 28.0l.l993 "Per Regjistrimin ne Regjistrin Tregtar"

V E N D O S A:

Depozitimin e vendimit nr 3 dt 03.07.2006 te mbledhjes se asamblese se jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise "ALB-BUILLDING" shpk, per:

1.Miratimin e raportit te ekspertit kontabel te Autorizuar Z. Luan Kamberi per zmadhimin e kapitalit te shoqerise me 53.400.000 leke nga fitimet e vitit ushtrimor 2005. Zmadhimi do te behet duke rritur vleren nominale te pjeseve te seicilit ortak.

-Kapitali i neshkruar i shoqerise nga 32.000.000 leke rritet dhe me 53.400.000 leke, behet 85.400.000 leke.

Vlera e re e nje kuote mbas zmadhimit te kapitalit do te jete 854.000 leke seicila.

2. Miratimin e ndryshimit ne piken 5 te Aktit te Themelimit per pjesen e kapitalit themelatr e cila riformulohet si me poshte: Kapitali themeltar i shoq nga 32.000.000 (tridhjeteedymilion)leke behet 85.400.000 leke(tetedhjetepesemiljonekaterqinmije)leke.

3.Miratimin e ndryshimet ne Statutin e shoqerise ne kapitullin 2 neni 7 Kapitali themeltar i shoq i cili riformulohet si me poshte. Kapitali themeltar i shoq nga 32.000.000 leke behet ne 85.400.000 leke, i ndare ne 100 pjese e nje vlere nominale prej 854.000 leke seicila. Seicili ortak zoteron 50 pjese te kapiatlit te shoqerise.

4. Ngarkohet administartori i shoq Odise Bresho te beje depozitimin e vendimit ne Regjistrin Tregtar.

5. vendimi perpilohet ne 3 kopje te barazvlefshme dhe te nenshkruhet rregullisht nga ortaket e shoqerise.

-Te ndahen regjistrimet nga njeri- tjetri me vije te kuqe dhe te behen shenimet ne kollonat perkatese.

Tirane, me 12 .07.2006

G J Y Q T A R E

Blerina MUÇA

AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë Tregëtare prodhuese Alb-Buillding Memaliaj

Në Tepelenë sot më datën 19-9-94 me Odise Bresho e Pëllumb Betaj bëjmë aktin e themelimit të shoqërisë me përgjegjësi ti kufizuar "Alb- buillding" Memaliaj, me këto kushte :

1-Kjo shoqëri do të ketë si aktivitet atë të ndërtimit të veprave social kulturore , industriale rrugë ,ujësjellsa etj të shfrytëzimit të materialeve inerte dhe prodhimin dhe tregëtimin e materialeve ndërtimit do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë 10 vjeçare , me të drejtë shtimin e tij

2-Vend që drimi legal i saj do të jetë qyteti Memaliajt Ajo ka të drejtë të hap filja le të tjera , të lidhet me persona fizik a juridik vendas a të huaj , veprime që do të kryhen në përputhje me legjistacionin në fuqi

3-Shoqëria e mësipërme do të ketë si objekt veprimtarinë private të ndërtimit,(ndërtimi objekteve industriale ,social kulturore rrugë ujësjellsa etj) ,shfrytëzimit përpunimit dhe tregëtimit të materialeve inerte si dhe prodhimin dhe tregëtimin e materialeve të të ndërtimit

4-Administrator i shoqërisë "Alb- buillding" do të jetë z Odise Bresho i diplomuar si ing miniere dhe ka eksperiencë në këtë fushë për shfrytëzimin dhe përpunimin e inerteve si dhe në fushën e ndërtimit

5-Kapitali themelor fillestar do të jetë 100000 lekë në pjesë të barabart midis dy ortakëve

6-Fitimi nga aktiviteti i shoqërisë në fund të cdo viti sipas bilancit dhe likujdimit të të gjitha detyrimeve e shpenzimeve do të ndahet në raport me kapitalin e vendosur nga ortakët

7-Cdo ortakë ka të drejtë të punësohet në shoqëri konform legjistacionit të punës , me kontrat ~~industrial~~ individuale e kolektive Edhe paga do të jetë si e gjithë punonjësve të tjerë

8-Si rregull do të jetë që ortakët e gjallë në cdo rast trasferimi të pjesëve të tyre ,ose shitje të pjesës së kapitalit që zotërojnë në këtë shoqëri , do t'jua ofrojnë ortakëve të tjerë të kësaj shoqërie(ortakut) Në rast vdekje veprohet me trashëgimi ,sipas legjistacionit tregëtar

9-Të gjitha shpenzimet e ëra , gjer në krijimin e kësaj shoqërie do të përballohen nga fondet e saj

10-Të gjitha mosmarrveshjet që nuk do të zgjidhen me bisedime do të zgjidhen nga gjykatet e vendit tonë sipas procedurave

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ROBERT SAJA

të zakonshëm

11-Akti i themelimit do të shtypet në 4(katër)kopje një nga të cilat do të mbahet në dokumentat e shoqërisë sh.p "Alb -buillding" kurse të tjerat do të depozitohen në organet përkatëse të drejtësisë dhe në ato shtetërore

ORTAKËT

Odise Bresho

Pëllumb Betaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NOTERIA TEPELENË

Nr.127/Rep.-

V Ë R T E T I M I

Sot më datën 20.09.1994 (Njëzetë Shtator Nëntëdhjetëekatër) ditën e "artë, në Tepelenë, para meje noterit Robert Salia, u paraqitën personalisht shtetasit: Odise Nuredin Bresho, i dt.1.7.12.1965, me banim në qytetin Memaliaj, me identitet të përcaktuar në letër njoftimin NF Nr.146045, dt.25.12.1982 të lëshuar nga Z.GJ.C Progonat, 2-Pëllumb Halil Beta, i dt.1.22.08.1959, me banim në qytetin Memaliaj, me identitet të përcaktuar në letër njoftimin NF Nr.152869, dt.2.06.1988 të lëshuar nga Z.GJ.C Memaliaj; mëdhor, me zotësi të plotë për të vepruar, deklaruan se: semësipër është shprehje e vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë përpiluar konformë dispozitave ligjore, Ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqërit tregtare", si dhe nënshkrimet janë të tyret. . . . . .

Përsamësipër vërtetohet në bazë të nenit 39/c të Ligjit "Për noterinë".. . . . . .

N O T E R I

(Robert Salia)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ROBERT SALIA NOTER TEPELENË

TULLE TAKSE 10 LEKE REPUBLIKA E SHQIPËRISË

S T A T U T

I shoqërisë Alb -Buillding Memaliaj

Kapitulli I-rë

Dispozita të përgjithshëme

Neni 1

Shoqëria Tregëtare prodhuese "Alb-buillding" ,shoqëri me përgjegjësi të kufizuar krijohet me prokurë nga dy bashkëpronar , nga Odise Nure in Bresho dhe Pëllumb Halil Betaj të dy banues në qytetin e Memaliajt

Neni 2

Vend qëndrimi legal (selia) do të jetë në qytetin e Memaliajt Ajo mund të hap filjale , përfaqësi apo agjensi në vende të tjera brenda teritorit të Republikës së Shqipërisë dhe mund të lidhet edhe me persona fizik e juridik jashtë vendit tonë sipas legjislacionit përkatës

Neni 3

Shoqëria Tregëtare Prodhuese "Alb Buillding" Memaliaj do të ketë vulën e saj në madhësi të zakonshëme dhe me inicialet përkatëse

Neni 4

Ajo do të ketë për objekt veprimtarinë private në fushën e ndërtimit (sipas licencës lëshuar nga Ministria e Ndërtimit strehimit dhe rregullimit teritorit) shfrytëzimin ,përpunimin shitjen e materialeve inerte si dhe prodhimin dhe tregëtimin e materialeve të ndërtimit

Neni 5

Kohzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë 10 vjet me të drejtë për tu shtuar Vendimi për zgjatjen e afatit merret nga përfaqësuesit e 2/3 të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje

Neni 6

Të dy bashkëpronarët kanë të drejtë të punësohen me përparësi në vaprimtarinë e shoqërisë në bazë të rregullave ligjore të Kodit të Punës

Kapitulli2

Kapitali themelor i shoqërisë

Neni 7

Kapitali fillestar themelor do të jetë 100000 lekë i paguar në mënyrë të barabartë nga të dy ortakët i mjaftueshëm për vazhdimin e aktivitetit Ky kapital mund të shtohet ose pakësohet me vendim të të dy ortakëve

Neni 8

Kuotat janë të trasferueshme me akt noterial me miratimin e ortakëve të gjallë , kur vdekja e njërit prej ortakëve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ROBERT SAJA NOTER TEPELENË

asambleja e ortakëve me shumicë kapitali 3/4 etj Kuotat mu shiten brenda ortakëve dhe mund të trashëgohen vetëm në ras të ortakëve Shitja dhe blerja e tyre bëhet sipas vlerës n të tyre që ka në kohën e marrjes së këtij vendimi

Neni 9

Kapitali mund të përfaqësohet direkt nga bashkë pronar ose me autorizim me shkrim të një ortaku për ortakun tjetër Asam - leja me vendim të saj mund të zgjidh një kpshill drejtues , numuri dhe kopetencat e tij do të përcaktohen prej tyre

Kapitulli i III

Asambleja e ortakëve

Neni 10

Asambleja përfaqëson të gjithë ortakët dhe vendimet e tyre të marra konform ligjit dhe statutit janë të detyrueshme për të gjithë Asambleja është e zakonshëme dhe e jashtëzakonshëme në mbledhjet e saj Ajo si rregull mblidhet në selinë e shoqërisë dhe drejtohet nga administratori Proces verbali mbahet nga një sekretar Lajmërimi për mbledhje i ortakëve bëhet të paktën 7 ditë përpara xpër dhe me shkrim ku tregohet dhe rendi i ditër

Mblehjet e zakonshëme dhe të jashtë zakonshëme marrin vendime me miratim të të dy ortakëve , përveç problemeve që lidhën me kapitalin dhe zgjidhjen e administratorit , që duhen 3/4 e kapitalit pjesëmarrës

Neni 11

Palët mund të përfaqësohen nga persona të tjerë me prokurë të moterizuar , ose të vërtetuar nga administratori i shoqërisë Asambledhja mund të mblidhet edhe me kërkesën e një ortaku

Neni 12

V en imet e Asamblesë janë të vlefshëme kur pasqyrohen me proces verbalin e mble hjes dhe në të ka marrë pjesë shumica e kapitalit të firmosur nga të dy ortakët dhe sekretari i cili duhet të jetë i punësuar dhe jo ortakë

Neni 13

Shoqëria "Alb- buillding" është e detyruar të mbaj dokumentacion të rregullt ,të bëjë parashikime dhe të nxjerr bilance në afatet e caktuara (mujor , tremujor , vjetor) Të plotësoj të gjitha detyrimet ndaj shtetit dhe organeve shtetërore shqipëtare

Administrimi

Neni 14

Shoqëria "Alb- buillding" shpesh drejtohet nga administratori i saj z Odise Bresho i diplomuar si ing miniere i zgjedhur nga

Neni 15

Administratori është i veshur me kompetenca për zbatimin e vendimeve të asamblesë së ortakëve dhe drejtimin e gjithë punëve që ka shoqëria Ai përgatit materialet e mbledhjes dhe drejton veprimtarinë e përditshëme

Neni 16

Administratori përfaqëson ligjrisht shoqërinë para personave fizik e juridik , organeve të pushtetit , të administratës dhe atyre të drejtësisë Ai mund të autorizoj me prokurë edhe persona të tjerë që të kryejnë veprimtari juridike , brenda kompetencave të ligjit , statutit dhe vet prokurës

Neni 17

Administratori informon vazhdimisht ortakët për gjendjen ekonomike financiare të shoqërisë , dhe pasi nxjerr bilancin , brenda tremujorit I të vitit pasardhës raporton me shkrim në Asamblenë e ortakëve

Kapitulli V

Bilanci dhe fitimi

Neni 18

Veprimtaria e firmës mbyllet më 31 dhjetor të cdo viti Mbledhja për bilancin dhe llogarinë humbje fitime bëhet brenda datës 15 shkurt të cdo viti

Neni 19

Të ardhurat neto pasi hiqet një shumë prej jo më pak se 10 % për rezervë legale , që i shtohet kapitalit , ndahet me raporte të drejta në bazë të kuotave që ka secili ortak në kapitalin e shoqëri

Neni 20

Marëdhëniet e punës si pranimet dhe largimet nga puna ,pagat dhe shpërblimet , ndëshkimet dhe problemet e tjera rregullohen nga kontratat industriale me të punësuarit dhe me kontra kolektive , në bazë të legjislacionit të punës në Republikën e Shqipërisë

Neni 21

Shoqëria " Alb- Builldiing" sh.p.k Memaliaj fiton personalitin e saj juridik me rregjistrimin në Gjykatën e rrethit Tiranë , ushtron veprimtarinë e saj pasi bën rregjistrimin e saj në organin tatimor të rrethit Tepelenë

Kapitulli VI

Shkrirja dhe likujdimi

Asamblesa e ortakëve , në cdo moment dhe për cfardo shkaku me 3/4 e kapitalit vendos prishjen ose likujdimin e shoqërisë bashk ajo që cakton likujdatorin ose likujdatorët dhe kur nuk merren ves atëhere vendos gjykata e rrethit

Neni 23

Të gjitha mosmarrveshjet që nuk mund të zgjidhen me bisedime do të zgjidhen nga Gjykatat përkatëse të vendit tonë sipas procedurave të zakonshëme

Neni 24

Statuti shtypet në 4(katër) kopje nje nga të cilat mbahet dokumentat e shoqërisë dhe të tjerat depozitohen në organet e drejtësisë , të noterisë dhe pushtetit

Memaliaj, më 19 Shtator 1994,

O R T A K Ë T

1-Odise Bresho

2-Pëllumb Beta

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
NOTERIA TEPELENË
Nr.127/Rep.-

V Ë R T E T I M :

Sot më datën 20.09.1994 (Njëzetë Shtator Nëntëdhjetë-ekatër), ditën e Martë, në Tepelenë, para meje noterit Robert Salia, u paraqitën personalisht shtetasit: Pëllumb Halil Beta, i datëlindjes 22.08.1959, me vendlindje Vasjar dhe vendbanim në qytetin Memaliaj, me identitet të përcaktuar në letër njoftimin NF Nr.152869, datë 20.06.1988 të lëshuar nga Z.GJ.C Memaliaj dhe 2- Odise Nuredin Bresho, i datëlindjes 7.12.1965, me vendlindje Nivicë dhe me vendbanim në qytetin Memaliaj, me identitet të përcaktuar në letër njoftimin NF Nr.146045, datë 25.12.1982 të lëshuar nga Z.GJ.C Progonat-Tepelenë; madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, deklaruan se: samësipër është shprehje e vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë si dhe e nënshkruan para meje noterit. . . . . .

Përsamësipër vërtetohet në bazë të nenit 39/c të Ligjit "Për noterinë". . . . . .

N O T E R I

(Robert Salia)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ROBERT SALIA NOTER TEPELENË

TAKSE 10 LEKE REPUBLIKA E SHQIPËRISË

V E N D I M

NR! 1 Date 16-7.1996

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE TREGETARE
ALB - BUILLDING " SHPK

Asamblejane ortakeve te shoqerise Tregetare " ALB BUILLDING " SHPK ne mbledhjen e dates 16.7.1996 ka vendosur per nje shtese ne objektin e veprimtarise ne fushen e :

Kryerje punimesh per hapje, shfrytezim dhe mbyllje minierash.

Asambleja ne unanimitet te plote votash ka

v e n d o s u r

Pranimin e kerkeses per shtese ne objektin e veprimtarise ne fushen e kryerje punimesh per hapje, shfrytezim dhe mbyllje minierash.

ORTAKET E SHOQERISE ~~Odise~~

ODISE BRESHO

PELLUMB BETAJ

REOUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
Nr. 4858 Rep
1996

Tirane ,me 29.7.1996

V E R T E T I M

Vertetohet se vendimi i asamblese se ortakeve te shoqerise Tregetare " Alb Building " SHPK u nenshkrua ne prezencen time nga kerkuesit ortak te shoqerise z. Odise Bresho dhe Pellumb Betaj dhe une notere duke e gjetur te rregullt e nenshkruaj si me poshte.

N O T E R E

/ _____ /

POLLE TAKSE
50 LEKE

NOTERE
PRANVERA KARAFILI
TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Shoqeria"ALB-BUILLDING "sh.p.k

V E N D I M

I ASAMBLESE SE ZAKONSHME TE ORTAKEVE

Nr._1_ date 11.04.2005

Sote me date 11.04.2005 ne selin e shoqerise "ALB-BUILLDING" sh.p.k u mblodh Asambleja e zakonshme me pjesmarrjen zotrueseve te 100% te kuoteve.

Asambleja ka per **rend dite** :

- Shqyrtimi i dhe miratimi i bilancit te vitit 2004
- Diskutimi per procedurat e shtimit te kapitalit te shoqerise nga fitimet e akumuluara dhe fitimet e vitit 2004
- Emerimin e Ekspertit Kontabel per verifikimin dhe vertetimin e shteses se kapitalit.

Ne perfundim te diskutimeve te tyre ortaket e shoqerise ne unanimitet te plote :

V E N D O S E N

1-Te miratojne bilancin e vitit ushtrimor 2004 si dhe fitimin neto te vitit per 9.277.500 leke.
2-Te behet shperndarja e fitimeve te mbartura prej 23.028.067 leke dhe e vitit 2004 9.277.500 leke si me poshte:

- 31.900.000 leke per shtim te kapitalit te shoqerise
- 405.567 leke te shperndahet per ortaket si divident.

3-Te miratojne fillimin e procedurave per shtimin e kapitalit te shoqerise.

4.Te ngarkoje Ekspertin Kontabel te shoqerise z.Luan KAMBERI te pregtise raportin per zmadhimin e kapitalit dhe ta paraqes ne Aamblene e Jshtezakonshme te shoqerise.

5-Ngarkohet administratori I shoqerise z.Odise BRESHO te beje depozitimin e vendimit ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

6-Vendimi te perpilohet ne 3 kopje te barazvlefshme dhe te nenshkruhet rregullisht nga ortaket e shoqerise.

ORTAKET E SHOQERISE

Odise BRESHO — Pellumb BETAJ

ALB-BUILDING Shpk
TEPELENE
NT. 3550035

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Shoqeria"ALB-BUILLDING "sh.p.k

V E N D I M

I ASAMBLESE SE JASHTEZAKONSHME TE ORTAKEVE

Nr._2_ date 25.04.2005

Sote me date 25.04.2005 ne selin e shoqerise "ALB-BUILLDING" sh.p.k u mblodh Asambleja e Jashtezakonshme me pjesmarrjen zotrueseve te 100% te kuoteve.

Asambleja ka per **rend dite** :

-Shqyrtimi i raportit te Ekspertit Kontabel te Autorizuar z.Luan KAMBERI I ngarkuar nga Asambleja e Zakonshme e shoqerise per pregatitjen e raportit per zmadhimin e kapitalit.

-Diskutimi per ndryshimet ne **Aktin e Themelimit** dhe ne **Statutin** e shoqerise si pasoje e zmadhimit te kapitalit dhe zgjatjes pa afat te veprimtarise se shoqerise.

Ne perfundim te diskutimeve te tyre ortaket e shoqerise ne unanimitet te plote :

V E N D O S E N

1-Te miratojne raportin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar z.Luan Kamberi per zmadhimin e kapitalit te shoqerise me 31.900.000 leke nga fitimet e vitit dhe mbartura te shoqersie. Zmadhimi do te behet duke rritur vleren nominale te pjeseve te sejcilit ortake.

-Kapitali I nenshkruar I shoqerise nga 100.000 leke rritet dhe me 31.900.000 leke behet 32.000.000 leke.
Vlera e re e nje kuote mbas zmadhimit te kapitalit do te jete 320.000 leke sejcila.

2-Te miratojne ndryshimet ne **piken 5** te **Aktit te Themelimit per pjesen e kapitalit themeltar e cila riformulohet** si me poshte:

- Kapitali themeltar I shoqerise nga 100.000(njeqindemije) leke behet 32.000.000 leke (Tridhjeteedymiljon) leke

3-Te miratojne ndryshimet ne **Statutin** e shoqerise ne **Kapitullin 2 neni 7 Kapitali themeltar i shoqerise i cili riformulohet** si me poshte:

- Kapitali themeltar I shoqerise nga 100.000 (njeqindemije) leke behet **32.000.000** leke (tridhjeteedymiljon) leke,I ndare ne 100 pjese e nje vlere nominale prej 320.000 (treqindeenjezetemije) leke sejcila.Sejcili ortake zotron nga 50 pjese te kapitalit te shoqerise.

4- Te miratojne ndryshimet ne **Statutin** e shoqerise ne **Kapitullin 1 neni 5** **i cili riformulohet** si me poshte:

- Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete me afate te pa kufizuar.

5-Ngarkohet administratori I shoqerise z.Odise BRESHO te beje depozitimin e vendimit ne Rregjistrin Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

6-Vendimi te perpilohet ne 3 kopje te barazvlefshme dhe te nenshkruhet rregullisht nga ortaket e shoqerise.

ORTAKET E SHOQERISE

Odise BRESHO Pellumb BETAJ

RAPORT I
EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

MBI SHTIMIN E KAPITALIT TE NENSHKRUAR TE SHOQERISE "ALB-BUILLDING"SH.P.K

Une I quajturi Luan KAMBERI Ekspert Kontabel I Autorizuar I ngarkuar nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise "ALB-BUILLDING" Sh.p.k me Vendimin nr.1 date 11.04.2005 per verifikimin dhe vertetimin e shteses se kapitalit te shoqerise me fitimet e akumuluara dhe te vitit ushtrimor 2004,paraqese raportin si me poshte:

Shoqeria "ALB-BUILLDING"sh.p.k eshte krijuar me vendim te Gjykates se rrethit Tirane nr.6415 date 22.09.1994 dhe ka per objekt te veprimtarise se saj fushen e ndertimit,shfrytezimit dhe tregetimit te materialeve te ndertimit.

Me vendimin nr.6415/1 eshte bere shtese ne objektin e veprimtarise se shoqerise – kryerja e punimeve per hapje,shfrytezim dhe mbyllje miniere.

Ne momentin e themelimit kapitali I saj eshte 100.000 leke.

Qe nga krijimi I saje shoqeria ka ushtruar veprimtari kryesisht ne fushen e ndertimit dhe te tregetise si dhe ka realizuar fitime te cilat nuk i ka shperndare.
Ne mbledhjen e saje te dates 11 Prill 2005 shoqeria me vendimin nr.1 ka vendosur qe me fitimet e akumuluara dhe te vitit 2004 te beje shtimin e kapitalit themeltar.

